



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNICA

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KËRKESE

**PËR VLERËSIMIN E KONFLIKTIT NË MES TË KOMPETENCAVE KUSHTETUESE
SIPAS NENIT 113(3)(1) TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Prishtinë
22 Korrik 2025

I. HYRJE

1. Kjo kërkesë parashtrohet nga Presidentja e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 113, paragrafi 3, nënparagrafin 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se Presidentja e Republikës së Kosovës është e autorizuar të parashtrojë kërkesë në këtë Gjykatë lidhur me konfliktin në mes të kompetencave kushtetuese, Kërkesa dorëzohet në Gjykatë nëpërmjet përfaqësuesve të saj të autorizuar.
2. Drejtimi i Presidentes Gjykatës Kushtetuese vjen pas përpjekjeve të vazhdueshme të saj për ta lehtësuar procesin e një marrëveshjeje politike që do të rezultonte meë konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Duke marrë parasysh që, përkundër detyrimeve që dalin nga Kushtetuta dhe Aktgjykimi KO124/25, Kuvendi i Kosovës vazhdon të mos konstituohet, në mungesë të mekanizmave të tjerë kushtetues dhe ligjorë përmes të cilëve Presidentja mund të sigurojë konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në ushtrimin e kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidentja e Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë, dhe paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidentja e Republikës së Kosovës garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, duke marrë parasysh pasojat serioze për rendin kushtetues të Republikës së Kosovës në rast që Kuvendi nuk konstituohet sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, përmes kësaj kërkesë, Presidentja i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për vlerësimin preventiv dhe zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në rast të dështimit të Kuvendit të Kosovës për t'u konstituuar brenda afateve kushtetuese.
4. Lidhur me këtë, paragrafi 86 i Aktgjykimit në rastin nr. KO 124/25, në të cilin Gjykata Kushtetuese (tutje: Gjykata) ka vlerësuar kërkesën e parashtruar nga deputetët si të pranueshme, me arsyetimin se: *"Gjykata vlerëson se çështja e Seancës Konstituive të Kuvendit përbën çështje kushtetuese, e cila duhet t'i nënshtrohet vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66"*. Tutje, Gjykata në paragrafin 94 tutje kishte theksuar se: *"në të tilla rrethana, kur Kuvendi nuk arrin t'i përmbushë funksionet e tij bazike, përfshirë konstituimin dhe zgjedhjen e Kryetarit/es*

dhe nënkryetarëve të tij, *kjo përbën rrezik të drejtpërdrejt për parimin e përfaqësimit dhe për ekuilibrin e pushteteve, ndaj kërkon një përgjigje të qartë dhe parimore nga Gjykata."*

5. Cenimi i vazhdueshëm i parimeve themelore të rendit kushtetues përbën jo thjesht krizë institucionale, por rrezik real për destabilizimin e vetë themeleve mbi të cilat është ndërtuar shteti i Republikës së Kosovës. Një rend kushtetues që nuk është funksional në praktikë, nuk mund të garantojë as të drejta, as përfaqësim, as llogaridhënie, dhe, për pasojë, nuk mund të ruajë legjitimitetin e tij as tek qytetarët. Prandaj, sipas sqarimeve të bëra në këtë kërkesë, është esenciale që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë dhe zgjidhë këtë konflikt kompetencash, në mbrojtje të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

II. PRANUESHMËRIA E KËRKESËS

6. Neni 113, paragrafi 3, nënparagrafi 1, përcakton se Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështje që ndërlidhen me konflikt mes kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Neni 113, paragrafi 3, nënparagrafi 1 parasheh si vijon:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

3. *Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*

(1) konflikti mes kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

7. Kriteret mbi bazën e të cilave mund të ngritet konflikti i kompetencave janë të përcaktuara më tej në nenet 31 dhe 32 të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, sipas të cilave, kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës, parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që

cenohet drejtpërdrejt nga i njëjti konflikt, ndërsa kërkesa parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

8. Më tej dhe bazuar në rregullin 66 të Rregullores 01/2023 së Punës së Gjykatës, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti pretendon se ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.
9. Kriteret mbi bazën e të cilave ngritet konflikti i kompetencave para Gjykatës Kushtetuese janë të përcaktuara më tej në dy raste të Gjykatës, konkretisht rastet KO131/18 dhe KO181/18. Në këto dy raste, Gjykata ka sqaruar se për parashttrimin e një kërkesë të tillë, duhet të plotësohen tri kërkesa të nivelit kushtetues, përkatësisht që: (i) konflikti të ngritet nga njëra nga tri palët e autorizuar; (ii) konflikti të ngritet për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar; dhe (iii) të ketë një konflikt (KO131/18; KO181/18, prg. 58).
10. Lidhur me natyrën e konfliktit, praktika e lartpërmendur gjyqësore thekson se çdo rast i konfliktit mes kompetencave kushtetuese do të vendoset në dritën e rrethanave të secilit rast që parashtrohet, por bazuar në kushtet dhe kufizimet kushtetuese të parashikuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregulloren e Punës (KO131/18, para. 96, 97). Gjithashtu, sqarohet se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese lidhur me konfliktin e kompetencave mund të jetë i karakterit preventiv ex-ante, por edhe ex-post (KO131/18, prg. 97).
11. Në këtë pikë, duhet rikujtuar se Rregullorja e re e punës së Gjykatës ka eliminuar specifikisht kriterin që ekzistonte më parë, me të cilin kërkohej që, për t' u ngritur një rast bazuar në konflikt kompetencash, duhej të kontestohet medoemos një "akt". Prandaj, praktika e lartpërmendur gjyqësore, në kontekst të kriterëve të pranueshmërisë për konflikt kompetencash, duhet të shihet edhe në dritën e këtij ndryshimi normativ.
12. Kjo kërkesë e Presidentes i plotëson kriteret kushtetuese, ligjore, rregullative dhe të praktikës gjyqësore. Së pari, Presidentja e Republikës është palë e autorizuar për të ngritur çështjen e konfliktit të kompetencave bazuar në paragrafin 3 të nenit 113 të Kushtetutës. Së dyti, konflikti i kompetencave ngritet lidhur me kompetenca kushtetuese dhe atë specifikisht, lidhur me paragrafin 3 të nenit 4 të Kushtetutës, sipas të cilit

Presidentja e Republikës përfaqëson unitetin e popullit, është përfaqësuese legjitime e vendit brenda dhe jashtë dhe garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë, dhe paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidentja e Republikës garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë. Së treti, ekziston një konflikt kompetencash, veçanërisht mes Presidentes së Republikës dhe Kuvendit të Kosovës, sepse, siç do të trajtohet më tej, mungesa e konstituimit të Kuvendit përtej afateve të përcaktuara në nenin 66 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin KO124/25, i pamundëson Presidentes së Republikës të ushtrojë në mënyrë efektive kompetencat e përcaktuara përmes neneve 4 dhe 84 të Kushtetutës. Duhet të theksohet se, bazuar në nenin 31 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkesa sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës, parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejt nga i njëjti konflikt. Rrjedhimisht, për të paraqitur kërkesë për konflikt kompetencash, Presidentja jo domosdoshmërisht duhet të jetë e cenuar nga konflikti i pretenduar, sepse neni 31 i Ligjit përfshin gjuhë alternative, pra cilado palë e autorizuar në konflikt ose cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejt nga i njëjti konflikt. Në rrethanat aktuale, megjithatë janë të plotësuara të dy kriteret. Presidentja e Republikës është edhe palë e autorizuar në konflikt, por edhe palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejt nga konflikti.

13. Më tej dhe siç u argumentua edhe më lart, Gjykata Kushtetuese, në rastin KO131/18, ka theksuar qartë se vlerësimi i konfliktit të kompetencave mes institucioneve kushtetuese përfshin edhe vlerësim ex-ante dhe ex-post të konfliktit të kompetencave. Në këtë Aktvendim, Gjykata ka sqaruar se “gjuha e Kushtetutës, por edhe gjuha e Ligjit që e konkretizon më tej dispozitën kushtetuese të parashikuar në nenin 113.3 (1), le të kuptohet që kemi të bëjmë me një juridiksion të Gjykatës Kushtetuese të karakterit preventiv, përkatësisht kontroll kushtetues ex-ante, por që nuk përjashton as një kontroll kushtetues ex-post. Thënë ndryshe, pretendimi për konflikt mes kompetencave kushtetuese, që është gjuha e përdorur nga Kushtetuta, mund të paraqitet para se të ndodhë konflikti ose pasi një konflikt kompetencash kushtetuese të ketë ndodhur.”
14. Përmes kësaj kërkesë, kërkohet që të bëhet vlerësimi preventiv i konfliktit të kompetencave, në rast të dështimit të konstituimit të Kuvendit brenda afatit 30-ditor sipas Aktgjykimin KO124/25 ose në rast të konstituimit të Kuvendit pas këtij afati, që në

të dyja rastet, do të mund të rezultonte me bllokim të plotë të institucioneve shtetërore. Prandaj, vetë natyra preventive e kontrollit kushtetues ex-ante të konfliktit mes kompetencave, do të mund ta parandalonte një bllokadë të tillë me pasoja jashtëzakonisht të dëmshme dhe të pariparueshme për vendin dhe rendin kushtetues.

15. Duhet të theksohet se vlerësimi dhe zgjidhja e këtij konflikti të kompetencave nga Gjykata Kushtetuese, në rast të dështimit të konstituimit të Kuvendit brenda afatit 30-ditor, është mundësia e vetme për ruajtjen e funksionalitetit të rendit kushtetues, duke marrë parasysh kufizimin e kompetencave kushtetuese të Presidentes për të ndërmarrë veprime procedurale tjera lidhur me konstituimin e Kuvendit. Së pari, sepse, lidhur me konstituimin e Kuvendit, Presidentja ka kompetencën që të thërrasë seancën e parë të Kuvendit, bazuar në paragrafin 3 të nenit 66 të Kushtetutës, kompetencë kjo që Presidentja e ka ushtruar brenda afatit të përcaktuar në nenin 66 të Kushtetutës. Së dyti, sepse, në rast të moskonstituimit të Kuvendit brenda afateve kushtetuese, Presidentja nuk mund ta shpërndajë Kuvendin, sepse rrethanat e shpërndarjes së tij janë shprehimisht të listuara në nenin 82 të Kushtetutës dhe nuk parashikojnë rrethanat e moskonstituimit të Kuvendit. Gjithashtu, dy Aktgjykime të Gjykatës tashmë, KO119/14 dhe KO124/25, kanë sqaruar se mungesa e konstituimit të Kuvendit nuk nënkupton shpërndarjen e Kuvendit dhe shkuarjen në zgjedhje të jashtëzakonshme.
16. Duke ju referuar më tutje praktikës së Gjykatës, në Aktgjykimin në rastin KO 80/10, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur të pranueshme kërkesën e Presidentit të Republikës lidhur me konfliktin e kompetencave, meqë mungesa e qartësive të çështjeve kushtetuese e parandalonte Presidentin të ushtronte kompetencën e tij kushtetuese për ushtrimin e kompetencës. Njësoj, në rastin konkret, moskonstituimi i Kuvendit po pengon ushtrimin e një sërë kompetencash të Presidentes. Në anën tjetër, konstituimi i Kuvendit pas afatit kushtetues mund të thellojë këtë krizë edhe më tepër, meqë qoftë mandatimi i Qeverisë, apo dekretimi i një sërë aktesh tjera që do të vinin nga një Kuvend i konstituuar pas afatit bien ndesh me Kushtetutën.
17. Në rastin nr. KO 88/21 të parashtruar nga Presidentja, Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar se kushti i dytë, gjegjësisht kushti që konflikti të ngrihet për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë, nuk ishte plotësuar. Gjykata kishte vlerësuar se ky kusht nuk ishte plotësuar për faktin se kompetenca për t'i emëruar anëtarët e KQZ-së, buronte nga Ligji për KQZ-në, e jo nga Kushtetuta (paragrafi 72). Për dallim nga rasti KO

88/21, konflikti aktual i kompetencave, për të cilin parashtrohet ky rast, buron pikërisht në kompetencat kushtetuese të Presidentes të përcaktuara në nenin 84, paragrafët 2, 4, 5, 10, 12, 14, 19, 20, 21, 22, 24, 25 dhe 30 të Kushtetutës.

18. Në rastin nr. KO 131/18, Gjykata në paragrafin 90 ka rikujtuar se autoriteti i Presidentes për të referuar çështje kushtetuese duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113, ashtu siç edhe është rasti aktual. Prandaj e gjithë kjo praktikë e gjykatës dëshmon se të gjitha kriteret kushtetuese të parapara lidhur me ngritjen e këtij rasti, janë plotësuar.
19. Në fund, sipas paragrafit 4 të Rregullit 66, Gjykata njofton autoritetin, konflikti i kompetencave i të cilit pretendohet, dhe ai autoritet duhet të përgjigjet brenda afatit të caktuar. Në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kësaj pike, duhet theksuar dy elemente. E para, sipas praktikës së deritanishme, të gjitha kërkesat që vijnë nga Gjykata Kushtetuese u shpërndahen deputetëve për përgjigje përmes administratës. Njësoj është vepruar edhe në tri rastet e fundit të iniciuara nga AAK-ja, PDK-ja dhe LDK-ja. E dyta, Gjykata Kushtetuese ka praktikë gjyqësore në të cilën ka dhënë përgjigje mbi konfliktin e kompetencave edhe pa pranuar përgjigje nga Kuvendi, edhe në kohë kur ai ishte krejtësisht funksional. Prandaj, mospërgjigjja eventuale nga Kuvendi në pretendimet e Presidentes për konflikt kompetencash përmes kësaj kërkeje nuk pamundëson adresimin e çështjes nga kjo Gjykatë. Madje, kushtëzimi eventual i pranueshmërisë së kësaj kërkeje me një përgjigje të domosdoshme nga Kuvendi do të çonte drejtpërdrejt në kufizim të së drejtës së Presidentes për të realizuar të drejtat e saj sipas nenit 113 (3) (1) të Kushtetutës. Kjo do të krijonte një ndërrvarësi ekstreme që, në praktikë, do të rezultonte me bllokimin total edhe të institucioneve të tjera vetëm për shkak të bllokimit të njërit.
20. Në sqarimin e Gjykatës Kushtetuese, respektivisht në Aktgjykimin në rastin nr. KO 103/14, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kushtetuta e mandaton Presidenten e Republikës së Kosovës edhe me përgjegjësinë për: *“të ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues”,* si dhe *“për të ruajtur stabilitetin e vendit.”* Konkretisht, Gjykata në paragrafin 61 të këtij Aktgjykimi, thekson se: *“mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues”,* duke shtuar tutje në paragrafin 94 se: *“sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit... është përgjegjësi e Presidentit të ruajtë stabilitetin e vendit”.*

21. Duke u bazuar në të lartcekurat, kërkojmë me respekt nga Gjykata që ta shpallë këtë kërkesë të pranueshme për shkak të plotësimit të të gjitha kriterëve të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese si dhe praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate.

III. EKZISTENCA E KONFLIKTIT NË MES TË KOMPETENCAVE KUSHTETUESE

22. Kërkesa në fjalë ka të bëjë me ekzistencën e një konflikti real të kompetencave ndërmjet institucioneve kushtetuese, konflikt ky i cili buron nga moskonstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke pamundësuar ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Qeverisë dhe Presidentes së Republikës. Ky konflikt rrezikon të bëhet edhe më i thellë në rast se konstituimi i Kuvendit nuk bëhet brenda afatit kushtetues prej 30-ditësh, siç është përcaktuar me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO124/25. Siç do të argumentohet më poshtë, në rast se Kuvendi nuk arrin të konstituohet deri në ditën e 30-të pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit KO124/25, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës do të jetë në krizën më të thellë kushtetuese që nga miratimi i Kushtetutës.
23. Në dritën e ndërlidhshmërisë së punës dhe kompetencave të Kuvendit me ato të Presidentes dhe Qeverisë, mungesa e një Kuvendi të konstituuar, apo edhe e një Kuvendi të konstituuar pas afatit prej 30-ditësh, përveç që cenon ushtrimin efektiv të një numri kompetencash të Presidentes, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të cenojë edhe: (a) ushtrimin e sovranitetit të Republikës së Kosovës përmes përfaqësuesve të zgjedhur (neni 2 i Kushtetutës), (b) formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve (neni 4 i Kushtetutës), dhe (c) vlerat kushtetuese të Republikës së Kosovës (neni 7 i Kushtetutës). Prandaj, në vazhdim të kësaj kërkesë, do të sqarohet cenimi i vlerave themelore të Republikës së Kosovës si pasojë e moskonstituimit të Kuvendit dhe, më pas, mënyra se si mungesa e konstituimit të Kuvendit apo konstituimi i tij pas afateve kushtetuese, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e kompetencave nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

1. Cenimi i vlerave fundamentale të Republikës së Kosovës si pasojë e moskonstituimit të Kuvendit – konflikti i kompetencave mes pushteteve

24. Moskonstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me funksionimin e një Qeverie në detyrë që ka kompetenca të kufizuara bazuar në Ligjin Nr.08/L-117 për Qeverinë, do të cenonte në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Rrethana në të cilën Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do të konstituohej brenda afatit 30-ditor do të cenonte në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat themelore të Kushtetutës së Kosovës, duke përfshirë nenet 2, 4 dhe 7 të Kushtetutës.
25. Së pari, neni 2 i Kushtetutës përcakton se sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute. Në kushtet kur Kuvendi nuk është konstituuar brenda afatit kushtetues, pamundësohet përfaqësimi legjitim i qytetarëve në institucionin më të lartë përfaqësues dhe, rrjedhimisht, edhe ushtrimi i sovranitetit. Prandaj, mbrojtja e sovranitetit me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë ndërlidhet po ashtu me Kuvendin si bartës i tij. Në thelb, mungesa e ushtrimit efektiv të sovranitetit nënkupton edhe mungesën e kapacitetit shtetëror për të vepruar institucionalisht dhe për të përmbushur funksionet themelore të Republikës së Kosovës. Nëse përfaqësimi demokratik dhe institucional nuk garantohen në praktikë, atëherë rrezikohet jo vetëm rendi kushtetues, por edhe vetë koncepti i shtetit sovran dhe funksional të Republikës së Kosovës.
26. Moskonstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës në ndërlidhje me funksionimin e një Qeverie në detyrë që ka kompetenca të kufizuara, duke i pamundësuar Presidentes të ushtroj një sërë kompetencash të saj kushtetuese, përbën jo vetëm një bllokadë institucionale, por edhe një cenim të drejtpërdrejtë të ushtrimit të sovranitetit të Republikës së Kosovës, siç parashihet në nenin 2 të Kushtetutës. Siç ka theksuar edhe Gjykata Kushtetuese në paragrafin 105 të rastit KO124/25: “ushtrimi i sovranitetit përmes të zgjedhurve të popullit është modaliteti kryesor dhe më i përhapur për të shprehur atë se çfarë “buron nga populli” dhe për ta reflektuar atë në veprime dhe vendime konkrete përmes sistemit të demokracisë përfaqësuese. [...] Në këtë mënyrë, Kuvendi si përfaqësues i sovranit, sovranitetin e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, në pajtim me Kushtetutën, e cila gjithashtu buron nga populli dhe manifeston vullnetin e

popullit për një shtet të lirë, demokratik e paqedashës, atdhe i të gjithë qytetarëve të vet, qytetarë të barabartë në të drejta dhe me barazi para ligji, që do të jetojnë në shtetin e tyre si shtet i mirëqenies ekonomike e prosperitetit social, i cili shtet si anëtar i denjë i familjes së shteteve të lira e paqedashëse kontribuon në stabilitetin rajonal e evropian përmes bashkëpunimit e fqinjësisë së mirë dhe që synon integrim Euro-Atlantik (shih Preambulën e Kushtetutës). Këto ideale të sovranit të materializuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të mbesin zotime të papërmbushura kurdo dhe çdoherë që përfaqësuesit e sovranit, nuk udhëhiqen nga parimi i bashkëpunimit me (mirë)besim dhe nuk angazhohen në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse për zgjidhjen e cilësdo situatë që mund të krijojë apo që ka krijuar jofunksionalitet të organit përfaqësues apo institucioneve tjera kushtetuese e shtetërore”.

27. Së dyti, nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, përcaktojnë se një ndër vlerat fundamentale të Republikës së Kosovës është ndarja e pushteteve dhe kontrolli dhe balancimi mes tyre. Në rrethana të moskonstituimit të Kuvendit brenda afateve kushtetuese dhe sipas Aktgjykimit KO124/25, ky parim do të jetë cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në këtë aspekt, është i rëndësishëm ndërveprimi i një sërë nenesh të Kushtetutës. Fillimisht, mungesa e një Kuvendi të konstituuar pamundëson ushtrimin e pushtetit legjislativ të Kuvendit sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Kushtetutës dhe ushtrimin e të gjitha kompetencave të Kuvendit të listuara në nenin 65 të Kushtetutës, përfshirë zgjedhjen, shprehjen e mosbesimit dhe mbikëqyrjen e Qeverisë. Më pas, mungesa e një Kuvendi të konstituuar pamundëson nënshkrimin e Qeverisë ndaj kontrollit parlamentar sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Kushtetutës dhe ushtrimin efektiv dhe të pakufizuar të të gjitha kompetencave të Qeverisë dhe Kryeministrit të listuara në nenet 93 dhe 94 të Kushtetutës. Ndërsa, marrë parasysh ndërveprimin e Presidentes së Republikës së Kosovës me Kuvendin, Presidentes i pamundësohet ushtrimi i kompetencave të saj kushtetuese të përcaktuara me nenin 84 të Kushtetutës, veçanërisht atëherë kur ushtrimi i kompetencës varet nga veprimi paraprak apo pasues i Kuvendit të Kosovës, përfshirë kompetencat nën pikat 5, 6, 7, 8, 14, 19, 30, të nenit 84 të Kushtetutës. Duke marrë parasysh se Kuvendi është institucioni prej të cilit buron sovraniteti i Republikës dhe përfaqësimi i popullit, mosfunksionalizimi i tij rezulton në cenim të drejtpërdrejtë edhe të kompetencave tjera të Presidentes dhe të Qeverisë, duke ndikuar në tërësinë e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

28. Gjykata Kushtetuese, në një numër aktgjykimesh, ka theksuar rëndësinë e parimit të ndarjes së pushteteve si “parim themelor i nivelit më të lartë kushtetues, i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit, i cili, si i tillë, është i panegociueshëm” (paragrafi 158, Aktgjykimi në rastet KO100/22 dhe KO101/22). Tutje, Gjykata i referohet këtij parimi si “vlerë demokratike në kuadër të organizimit të rendit kushtetues në Republikën e Kosovës” (paragrafi 73, Aktgjykimi në rastin KO43/19). Në këtë rast, Gjykata kishte theksuar se secila degë e pushtetit shtetëror duhet të veprojë në pajtim me Kushtetutën dhe përbrenda fushëveprimit kushtetues, duke garantuar kështu parimin e ndarjes së pushteteve dhe vlerave demokratike të qeverisjes. Po i njëjti aktgjykim, në paragrafin 64, potencon se “lidhshmëria mes autorizimeve që populli u jep përfaqësuesve të zgjedhur është konfirmuar në praktikën e Gjykatës, ku është theksuar se “Demokracia, ‘vox populi’ (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do t’i përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të Shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky është subjekti më i lartë drejtues, i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që, në të njëjtën kohë, i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Një nga përgjegjësitë kryesore të parlamentit është që të vendosë duke votuar se kë të fuqizojë me funksione ekzekutive.”
29. Së treti, mungesa e konstituimit të Kuvendit cenon në mënyrë serioze jo vetëm funksionalitetin institucional, por edhe vetë themelet dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar Republika e Kosovës. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në vlera dhe parime themelore të tilla si demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit dhe ndarja e pushteteve. Këto vlera nuk janë thjesht elemente normative të listuara në Kushtetutë, por përbëjnë themelin kushtetues dhe shtetëror të Republikës së Kosovës.
30. Në situatën aktuale, pushteti legjislativ është jofunksional për shkak të moskonstituimit të Kuvendit, ndërsa pushteti ekzekutiv është i kufizuar në kompetenca për shkak të statusit të Qeverisë në detyrë. Tutje, mungesa e Kuvendit nënkupton mungesë të kontrollit ndaj ekzekutivit, si dhe mungesë vendimmarrjeje sa i përket miratimit të ligjeve e vendimeve, ndërsa Presidentes, si bartëse e funksioneve të rëndësishme kushtetuese dhe si garantuese e funksionimit kushtetues të institucioneve, i pamundësohet ushtrimi i plotë i përgjegjësisë së saj. Si rezultat, balanca ndërmjet pushteteve është thellësisht e dëmtuar, duke e transformuar ndarjen e pushteteve nga një mekanizëm funksional të

kontrollit dhe baraspeshës institucionale në një gjendje bllokade që rrezikon rendin kushtetues dhe efektivitetin e shtetit.

31. Vendosja e institucioneve në situata të tilla të paqartësisë lidhur me zbatimin e Kushtetutës cenon seriozisht jo vetëm ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese, por edhe autoritetin e rendit juridik dhe integritetin e vetë shtetit, duke e bërë të domosdoshëm interpretimin e qartë dhe të menjëhershëm nga Gjykata Kushtetuese.

2. Cenimi i ushtrimit të funksioneve të Presidentes si garantuese e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës

32. Dy nene parësore janë të rëndësishme në kuptim të funksionit dhe ushtrimit të kompetencave kushtetuese të Presidentes:

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. *Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
2. *Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
3. *Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*
4. *Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*
5. *Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*
6. *Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
7. *Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.*

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës;
- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;

- (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;*
- (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;*
- (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;*
- (24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;*
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;*
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;*
- (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues, dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;*
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;*
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;*
- (30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.*

33. Moskonstituimi i Kuvendit, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e kompetencave të Presidentes të përcaktuara në nenin 4 dhe nenin 84 të Kushtetutës. Lidhur me paragrafin 3 të nenit 4 dhe paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, cenohet në mënyrë direkte kompetenca e Presidentes për të garantuar funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, me efekt të drejtpërdrejtë në ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe, rrjedhimisht, funksionimin demokratik të tërë rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Siç është sqaruar më lart, mungesa e konstituimit të Kuvendit pamundëson përfaqësimin e popullit të Kosovës, si dhe ushtrimin e sovranitetit shtetëror, duke paralizuar në tërësi rendin kushtetues.
34. Gjithashtu, mungesa e konstituimit të Kuvendit i pamundëson Presidentes ushtrimin e kompetencave të saktësuara në nenin 84 të Kushtetutës. Ushtrimi i kompetencave të Presidentes është i afektuar edhe kur Kushtetuta i referohet specifikisht ndërveprimit me Kuvendin, por edhe kur Kushtetuta nuk i referohet specifikisht këtij ndërveprimi, por ushtrimi i kompetencave të Presidentes varet nga ndërveprimi me Kryeministrin ose Qeverinë.

35. Lidhur me kategorinë e parë, në mungesë të konstituimit të Kuvendit, ushtrimi i të gjitha kompetencave të Presidentes që varen nga ndërveprimi me Kuvendin është në mënyrë të drejtpërdrejtë i cenuar, përfshirë lidhur me shpalljen e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; mundësinë e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj; nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën; propozimin e amendamenteve kushtetuese; caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit që përbën shumicën e Kuvendit; emërimin e gjyqtarëve për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit; emërimin e institucioneve të pavarura që votohen në kuvend, dhe të drejtuarit të paktën një herë në vit Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e saj.
36. Lidhur me kategorinë e dytë, në mungesë të konstituimit të Kuvendit dhe, rrjedhimisht, pamundësisë së Presidentes për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit që përbën shumicën e Kuvendit, në rrethana të një Qeverie në detyrë dhe pa mbikëqyrje parlamentare, ushtrimi i të gjitha kompetencave të Presidentes që varen nga ndërveprimi me Kryeministrin ose Qeverinë është në mënyrë të drejtpërdrejtë i cenuar, duke përfshirë lidhur me emërimin e Komandantit të Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit; emërimin e Drejtorit, Zëvendësdrejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; vendosjen për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin; vendosjen për formimin e misionëve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin; dhe emërimin dhe shkarkimin e shefave të misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë.
37. Janë gjithashtu dy kategori kompetencash presidenciale, të cilat janë të prekura në dëm të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës: politika e jashtme dhe siguria.
38. Sa i përket politikës së jashtme, ushtrimi i kompetencës për udhëheqjen e politikës së jashtme sipas neneve 4 dhe 84 të Kushtetutës është i ndërlidhur gjithashtu me funksionalitetin e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Kushtetuta e Republikës së Kosovës me nenin 84 (10) të saj, e ka mandatuar Presidenten e vendit me kompetencën e udhëheqjes së politikës së jashtme. Sipas Komentarit të Kushtetutës, kjo nënkupton se:

“koncepti i udhëheqjes së politikës së jashtme e vendos Presidentin e Republikës në pozicion të përcaktorit të linjave/ drejtimeve dhe objektivave të politikës së jashtme të shtetit, përderisa Qeveria (përkatësisht, organi i saj administrativ, Ministria e Jashtme) e bën materializimin e linjave të përcaktuara nga ana e presidentit. Në përgjithësi, është qartësisht e pranueshme që Presidenti i Republikës është autoriteti më i lartë i përcaktimit të politikës së jashtme të kuptim të linjave, përderisa Qeveria i nënshtrohet këtyre objektivave dhe zbaton politika qeverisëse për t’i adresuar ato në praktikë”. [Komentari i Kushtetutës, fq. 403].

39. Në këtë drejtim, mungesa e një Kuvendi funksional cenon drejtpërdrejt kompetencën e Presidentes për udhëheqjen e politikës së jashtme sipas interpretimit të mësipërm, meqë Kuvendi, si institucioni i vetëm i cili, në bazë të nenit 65 (9) të Kushtetutës, ushtron mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, e ka të pamundur ta realizojë këtë kompetencë kushtetuese në këtë fazë, konkretisht të vlerësojë nëse Qeveria është duke i zbatuar linjat e politikës së jashtme. Gjithashtu, siç përcaktohet me Kushtetutë dhe Ligjin nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, Kuvendi ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me territorin, paqen, aleancat, çështjet politike e ushtarake, të drejtat dhe liritë themelore, anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare, si dhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës. Në mungesë të Kuvendit, një numër i madh i këtyre marrëveshjeve kanë mbetur pa u ratifikuar. Humbjet për Republikën e Kosovës janë tejet të mëdha dhe, rrjedhimisht, disa nga institucionet shtetërore i kanë kërkuar Presidentes që, në interes të zhbllokimit, të bëjë ratifikimin e tyre nëpërmjet dekretit. Megjithatë, për shkak se këto marrëveshje bien brenda kategorive të nenit 18 të Kushtetutës që kërkojnë ratifikim në Kuvend, Presidentja nuk ka proceduar me nënshkrimin e tyre. Gjithashtu, meqë, sipas Kushtetutës, Presidentja është përfaqësuesja më e lartë brenda dhe jashtë vendit, mosratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare (qoftë atyre që janë në pritje, qoftë marrëveshjeve potenciale) ka penguar Presidenten në zbatimin sa më efektiv të kompetencës së ushtrimit të politikës së jashtme në raport me aleatët tanë ndërkombëtarë.
40. Përveç marrëveshjeve ndërkombëtare, mungesa e Kuvendit ndikon edhe në aspekte të tjera të udhëheqjes së politikës së jashtme nga ana e Presidentes. Meqë Qeveria në detyrë ka kompetenca të kufizuara dhe nuk mbikëqyret nga legjislativi, në mungesë të konstituimit, kjo parandalon arritjen e një sërë marrëveshjesh të reja në interes të Kosovës,

të cilat pastaj do të dekretoheshin nga Presidentja. Si rrjedhojë, ushtrimi i kompetencës si udhëheqëse e politikës së jashtme, si dhe përfaqësuesja më e lartë e shtetit brenda dhe jashtë vendit, cenohet nëpërmjet moskonstituimit të Kuvendit. E në rast se Kuvendi do të konstituohej jashtë afatit, pra, në kundërshtim me afatin kushtetues, ka rrezik që kjo kompetencë e Presidentes të cenohet edhe më shumë.

41. Sa i përket sigurisë, ushtrimi i kompetencës së Komandantes Supreme të Forcës së Sigurisë, sipas nenit 84 të Kushtetutës, është i ndërlidhur gjithashtu me funksionalitetin e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Në këtë drejtim, mungesa e një Kuvendi funksional cenon kompetencën e Presidentes si Komandante Supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, sepse, bazuar në Ligjin nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, ajo autorizon edhe dërgimin e FSK-së në operacione ndërkombëtare të paqes, por vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të ketë marrë vendimin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit në operacione ndërkombëtare të paqes. Në situatën aktuale, Presidentja e ka të pamundur të bëjë autorizime të tilla në mungesë të vendimit të Kuvendit, duke cenuar kështu kompetencën e saj kushtetuese si Komandante Supreme, si dhe duke penguar zhvillimin e FSK-së në bashkëpunim dhe ndërveprim me aleatët tanë të sigurisë.
42. Në shtesë të kësaj, siç është e ditur, Kosova është në kërcënim të vazhdueshëm nga Serbia, e cila asnjëherë nuk ka hequr dorë nga destabilizimi i Kosovës. Mungesa e Kuvendit do të pamundësonte, ndër të tjera, edhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në rast nevoje, duke rrezikuar kështu drejtpërdrejt sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës.

IV. KËRKESA PËR VLERËSIM PREVENTIV (EX ANTE) TË KONFLIKTIT TË KOMPETENCAVE

43. Siç është sqaruar më sipër, përmes kësaj kërkesë kërkohet vlerësimi preventiv i konfliktit të kompetencave kushtetuese si pasojë e mos-konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me efekt të drejtpërdrejtë në ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës. Mungesa e konstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues dhe atij të caktuar nga Aktgjykimi KO124/25, do të rezultojë në cenimin e ushtrimit të kompetencave të Presidentes, Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në

tërësinë e tyre, me pasoja të jashtëzakonshme në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

44. Pasojat për rendin kushtetues dhe ushtrimin e kompetencave të pushteteve në Republikën e Kosovës do të jenë jashtëzakonisht serioze në rast se Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit 30-ditor ose konstitutohet pas afatit 30-ditor sipas Aktgjykimit KO124/25, lidhur me interpretimin e nenit 66.1 të Kushtetutës, dhe, rrjedhimisht, në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës, sipas të cilit vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Një rrethanë e tillë do të rezultojë edhe në paqartësi lidhur me ushtrimin e kompetencave të Presidentes së Republikës dhe ndërveprimin me një Kuvend që nuk është konstituuar në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës dhe, rrjedhimisht, nenin 66 dhe 116 të Kushtetutës. Gjithashtu, marrë parasysh nenin 112.1 në lidhje me nenin 116.1 të Kushtetutës, afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin në rastin KO124/25, tashmë ka efektin e “normës kushtetuese juridikisht të detyrueshme”.
45. Në paragrafin II (2) të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO124/25, është konstatuar njëzëri se: “Deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ... duhet që sa më shpejt dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë të përfundojnë Seancën Konstituive të Kuvendit, duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij”. Në paragrafët 130, 184 dhe 190 të Aktgjykimit, Gjykata ka përcaktuar obligimet e grupeve parlamentare në raport me konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Gjykata ka obliguar grupin më të madh parlamentar për “bashkëpunim në mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare” për zgjedhjen e Kryetarit/es së Kuvendit, si dhe detyrimin e grupeve të tjera parlamentare për të vepruar “në frymën e bashkëpunimit dhe konsultimeve konstruktive” për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit.
46. Rrjedhimisht, duke u nisur nga interpretimi përfundimtar dhe i detyrueshëm i Gjykatës Kushtetuese për afatin 30-ditor të përcaktuar në nenin 66 (1) të Kushtetutës në njërën anë, si dhe, në anën tjetër, mungesën e konstituimit të Kuvendit brenda ose konstituimin e tij pas këtij afati, çështja e përputhjes me Kushtetutën e këtij Kuvendi të konstituuar pas afateve kushtetuese do të ndikojë drejtpërdrejt dhe fillimisht në kompetencën e Presidentes së Republikës të përcaktuar në paragrafin 14 të nenit 84 të Kushtetutës, lidhur

me caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë së Republikës, por edhe me ushtrimin e të gjithë kompetencave të tjera kushtetuese të Presidentes që ndërlidhen me funksionin e Kuvendit.

47. Për më tepër, është e nevojshme të sqarohet nëse konstituimi i Kuvendit pas afatit kushtetues poashtu përbën bazë për anulimin e akteve të miratuara nga një Kuvend i tillë. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi të sqarohet se a implikon një gjë e tillë cenim të rëndë të sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të gjitha palëve të prekura nga këto akte, të cilat i miraton Kuvendi.
48. Siç dihet, Kushtetuta është e qartë lidhur me pasojat juridike të moszgjedhjes së Qeverisë brenda afatit prej 60 ditësh, duke parashikuar shkuarjen e vendit në zgjedhje si pasojë (neni 82(1)(1) i Kushtetutës). Njëjtë parashihet që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme në rast të moszgjedhjes së Presidentit brenda afatit prej 60 ditësh (neni 82(1)(3) i Kushtetutës). Pasojat juridike janë parashikuar edhe kur institucionet e pavarura dështojnë të zgjidhen brenda afatit, duke sqaruar se, në këto raste konkrete, përsëritet konkursi. Kuvendi i Kosovës mbetet i vetmi institucion për të cilin është sqaruar afati kushtetues për konstituim, por nuk është sqaruar pasoja juridike e mosrespektimit të këtij afati.
49. Prandaj, vlerësimi dhe zgjidhja e konfliktit të kompetencave nga Gjykata Kushtetuese në këto rrethana është i domosdoshëm për mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.
50. Zgjidhja e këtij konflikti kompetencash detyrimisht reflekton nevojën që të sqarohen:
 1. Pasojat juridike të mungesës së konstituimit të Kuvendit brenda afateve të caktuara në nenin 66.1 sipas Aktgjykimit KO124/25 dhe, rrjedhimisht, në mospërputhje me nenin 66.1 dhe 116.1 të Kushtetutës.
 2. Pasojat juridike të konstituimit të Kuvendit pas afateve të caktuara në nenin 66.1 sipas Aktgjykimit KO124/25 dhe, rrjedhimisht, në mospërputhje me nenin 66.1 dhe 116.1 të Kushtetutës.
 3. Autorizimet, kufizimet dhe pasojat në ushtrimin e kompetencave të Presidentes së Republikës në raport me një Kuvend që konstituohet pas afateve të caktuara në nenin

66.1 sipas Aktgjykimit KO124/25 dhe, rrjedhimisht, në mospërputhje me nenin 66.1 dhe 116.1 të Kushtetutës.

51. Siç është sqaruar më sipër, në ushtrimin e kompetencave të nenit 84 të Kushtetutës, Presidentja e Republikës ndërvepron në mënyrë direkte ose indirekte me Kuvendin e Kosovës, përfshirë caktimin e mandatarit për Qeveri, dekretimin e ligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, e deri te kompetenca për shpërndarjen e Kuvendit në rast të plotësimit të kushteve kushtetuese për një gjë të tillë. Prandaj, është esenciale të vlerësohet nëse Presidentja mund t'i realizojë kompetencat kushtetuese dhe të ndërveprojë me një Kuvend të konstituuar pas afatit kushtetues.
52. Pavarësisht se, përgjatë Aktgjykimit KO124/25, Gjykata ka sqaruar se konstituimi i Kuvendit brenda këtij afati “është detyrues, jo opsional”, duke marrë për bazë mungesën e deritanishme të rezultateve konkrete në konstituimin e Kuvendit edhe pas 50 tentimeve, si dhe mungesën e saktësimit në Kushtetutë dhe në Aktgjykimin e Gjykatës lidhur me pasojat juridike që do të krijoheshin nga mosrespektimi i afatit, kërkojmë me respekt nga Gjykata Kushtetuese që të sqarojë se cilat do të jenë pasojat juridike në rast të moszbatimit të një obligimi të tillë.

IV. KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME PËR PEZULLIMIN E RRJEDHJES SË MËTEJME TË AFATIT 30 DITOR PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

53. Në mbështetje të nenit 116 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe duke pasur parasysh Rregullin 44 të Rregullores së Punës Nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese, Presidentja e Republikës së Kosovës kërkon nga kjo Gjykatë vendosjen e masës së përkohshme për pezullimin e rrjedhjes së mëtejme të afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri në vendimin përfundimtar lidhur me meritat e këtij rasti.
54. Paragrafit 2 i nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës përcakton si vijon:

"[...[

2. Përderisa procedura të mos perfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme."

[...]"

55. Gjithashtu, sa i përket masës së përkohshme, neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, përcakton se:

"1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale."

56. Në thelb të dispozitave të lartcekura që e mandatojnë Gjykatën Kushtetuese me kompetencën ekskluzive për të vendosur masë të përkohshme, qoftë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palëve, qëndrojnë elementet e *"parandalimit të dëmit të pariparueshëm"*, dhe vendosjes së masës së përkohshme *"në interes publik"*.
57. Si e tillë, kjo kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme është në linjë të plotë me këto kërkesa kushtetuese dhe ligjore, konkretisht me nevojën e domosdoshme për të parandaluar dëmin e pariparueshëm që mund t'i shkaktohet Republikës së Kosovës si dhe konfliktin e kompetencave në mes institucioneve kushtetuese si pasojë e drejtpërdrejtë e moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit 30-ditor, të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese, duke bërë që Kuvendi të jetë drejtpërdrejt në shkelje të Kushtetutës.
58. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se përkundër përcaktimit të këtij afati kushtetues dhe tashmë kalimit të 25 ditëve që nga shpallja e tij, mungesa e konsensusit politik për të

gjetur zgjidhjen e nevojshme për konstituimin e Kuvendit është shfaqur publikisht, por edhe në takimet individuale të Presidentes me liderët e partive politike.

59. Për më tepër, duke pasur parasysh edhe faktin se është e paqartë se cilat do të jenë pasojat juridike në rast të moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit 30-ditor, si dhe faktin se Gjykata Kushtetuese ka përckatuar shprehimisht se moskonstituimi i Kuvendit nuk e dërgon vendin në zgjedhje të reja parlamentare [Aktgjykimi KO 124/25, paragrafët 108, 143], pezullimi i rrjedhjes së afatit deri në sqarimin përfundimtar të kësaj çështje është i domosdoshëm për të parandaluar pasoja të pariparueshme dhe konflikt të ri kompetencash. Në të kundërtën, siç argumentohet më në detaje në vijim, konstituimi i Kuvendit pas afatit 30-ditor, ngre çështje tejet komplekse kushtetuese që ndërlidhen me kushtetutshmërinë e Kuvendit të konstituuar, e madje na dërgon në krizën më të thellë kushtetuese e institucionale që nga shpallja e pavarësisë së shtetit tonë. Rrjedhimisht, vendosja e masës së përkohshme nga Gjykata Kushtetuese, do të parandalonte thellimin e mëtejme të kësaj krize në të cilin ndodhet vendi tash e një kohë të gjatë.
60. Tutje, vendosja e masës së përkohshme për pezullimin e rrjedhjes së afatit 30-ditor është në interes publik të vendit, për të mundësuar, siç ka theksuar Gjykata Kushtetuese: “që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar”. Siç është vlerësuar nga vetë Gjykata në Aktgjykimin në rastin nr. KO 124/25, Kuvendi i Republikës së Kosovës është përfaqësues i sovranit, prandaj idealet e sovranitetit të mishëruara në Kushtetutë mbeten zotime të papërmbushura në mungesë të funksionalitet të organit përfaqësues apo institucioneve tjera kushtetuese e shtetërore [Aktgjykimi në Rastin nr. KO 124/25, paragrafi 105].
61. Për fund, vlen të theksohet se vendosja e masës së përkohshme në situatën aktuale, është e vetmja mundësi që shmang hyrjen e institucioneve në një krizë tjetër edhe më të thellë dhe pa rrugëdalje pas afatit 30 ditor. Rrjedhimisht, në vijim do të argumentohet se masa e përkohshme është i vetmi mjet që parandalon dëm të pariparueshëm si dhe është në dobi të interesit publik të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

1. Masa e përkohshme parandalon dëm të pariparueshëm

62. Moskonstituimi i Kuvendit tashmë i ka shkaktuar dëm të madh vendit, duke parandaluar marrëveshje ndërkombëtare tejet të rëndësishme, përfitime financiare në interes të qytetarëve, ligje e vendime që lidhen me sigurinë nacionale si dhe shumë çështje të tjera të cilat sikur të trajtoheshin e miratoheshin në Kuvend do të përmirësonin jetën e qytetarëve. Për më tepër, siç u theksua edhe më lart, moskonstituimi i organit legjislativ nënkupton se nuk mund të realizohet ushtrimi i sovranitetit siç parashihet me Kushtetutë, nuk funksionon parimi i ndarjes së pushteteve si dhe rrezikohen vlerat demokratike dhe parimet kushtetuese që qëndrojnë në themelet e rendit tonë kushtetues.
63. Në rastin nr. KO 72/20, Gjykata kishte vendosur të miratojë masën e përkohshme me arsyetimin se parashtruesit e kërkesës kishin ngritur një sërë çështjesh kushtetuese përkitazi me funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe ndarjen e pushteteve. Të tilla çështje, sipas Gjykatës, pa vendosjen e masës së përkohshme, kanë potencial të shkaktojnë dëme të pariparueshme në aspekt të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe funksionimit të institucioneve kyçe në Republikën e Kosovës. [paragrafi 49 i Vendimit për masë të përkohshme në rastin nr. KO 72/20].
64. Gjithashtu, në rastin nr. KO 119/14, Gjykata kishte miratuar kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme për pezullimin e procesit të konstituimit të Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës, me argumentin se mungesa e masës së përkohshme mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës. [paragrafi 27 i Vendimit për masë të përkohshme në rastin nr. KO 119/14].
65. Duke qenë se Gjykata ka sqaruar në Aktgjykimin nr. KO 124/25 se konstituimi i Kuvendit brenda 30 ditësh është normë detyruese kushtetuese, kjo nënkupton se nëse një gjë e tillë nuk ndodhë brenda afatit, atëherë mund të ketë pasoja edhe më të rënda, të cilat lindin nga mosrespektimi i këtij afati, e që ndër të tjera përfshinë mundësinë që një Kuvend i konstituuar pas afatit të konsiderohet kundërkushtetues, që aktet e miratuara nga ky organ poashtu të konsiderohen kundërkushtetuese e që edhe Kryetari e nënkryetarët e Kuvendit si dhe Qeveria e votuar nga ky Kuvend të jetë poashtu kundërkushtetues.

Rrjedhimisht, e gjithë kjo situatë përveçse do të rrezikonte edhe më tej rendin kushtetues, poashtu do të krijonte konflikt të ri kompetencash për institucionin e Presidentit të Republikës sepse do të krijonte paqartësi nëse Presidentja mund të procedojë me mandatin e Qeverisë, dekretimin e akteve të Kuvendit, dekretimin e organeve të pavarura të zgjedhura nga Kuvendi, dekretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, akteve që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe çështje të tjera që lidhen me sigurinë kombëtare, e të tjera.

66. Për më tepër, një situatë e tillë do të kishte për pasojë, ndër të tjera, edhe uljen e mëtejme të besimit qytetar në institucionet kushtetuese si dhe dëmtimin e integritetit të tyre brenda e jashtë vendit. Kjo poashtu do të rezultonte me rrezikim të demokracisë, shkelje të vazhdueshme të parimit të ndarjes së pushteteve si dhe shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve për shkak të mungesës së institucionit ku miratohen ligje e vendime lidhur me të drejtat e tyre.
67. Duke e ditur se pasojat e tilla do të ishin të pariparueshme për vendin, kërkojmë me respekt nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e afatit 30 ditor, deri në marrjen e vendimit përfundimtar të kësaj Gjykate lidhur me meritat e kërkesës. Pezullimi i këtij afati do t'u jepte deputetëve së paku pak ditë kohë pas aktgjykimit që të reflektojnë lidhur me pasojat juridike që do të krijoheshin nga moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit dhe mund të ketë efekt pozitiv edhe në krijimin e konsensusit lidhur me konstituimin e Kuvendit menjëherë pas aktgjykimit të Gjykatës lidhur me këtë kërkesë.

2. Masa e përkohshme është në interes publik

68. Në rastin nr. KO 72/20, Gjykata kishte theksuar se çështjet kushtetuese të ngritura në atë kërkesë lidhur me respektimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese që rregullojnë funksionimin demokratik të institucioneve të themeluara me Kushtetutë dhe ndarjen e pushteteve janë të një rëndësie dhe natyre të atillë që pashmangshëm e bëjnë miratimin e masës së përkohshme çështje të interesit publik për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj. [paragrafi 50 i Vendimit për masë të përkohshme]. Edhe në rastin konkret kemi të bëjmë pikërisht me çështje kushtetuese që rregullojnë ndarjen e pushteteve si dhe funksionimin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe parimet e demokracisë.

69. Për më tepër, në rastin nr. KO 12/17, Gjykata kishte miratuar kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme me arsyetimin se mospezullimi i ligjit të kontestuar mund të rezultonte me shkelje të të drejtave të njeriut për qytetarët që prekeshin nga ky ligj. Gjykata kishte konsideruar se çështjet e ngritura në kërkesë janë të një rëndësie të tillë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe për administrimin e duhur të sistemit të drejtësisë, ndaj adresimi i tyre para zbatimit të dispozitave të kontestuara të ligjit të kontestuar është në interesin publik. [paragrafi 41 i Vendimit për masë të përkohshme]. Në rastin konkret, mungesa e vendimeve e ligjeve nga Kuvendi që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore si dhe interesat e qytetarëve, apo në rastin më të keq shpallja kundërkushtetuese e akteve të Kuvendit nëse do të konstituohej pas afatit, do të rezultonte me shkelje të të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve tanë, prandaj edhe kërkesa për masë të përkohshme, lidhet substancialisht me interesin publik.
70. Është plotësisht e qartë se interesi i Republikës dhe i qytetarëve të Kosovës është që të funksionojnë të gjitha pushtetet e parapara me Kushtetutë, që të mbrohen vlerat demokratike, që të ushtrohet sovraniteti, të funksionojnë institucionet në përputhje me Kushtetutën, si dhe të ushtrohet funksioni i legjislativit në mënyrë që të merren vendime në interes publik. Pa Kuvend, nuk ka se si të merren këto vendime e as të kryhet funksioni mbikqyrës i legjislativit mbi ekzekutivin për çështje të interesit publik. Për më tepër, një Kuvend i konstituuar pas afatit kushtetues, e potencialisht kundërkushtetues, nuk do të jetë në gjendje të marrë vendime në interes publik, duke e lënë kështu Kosovën në krizën më të thellë institucionale e kushtetuese që nga shpallja e pavarësisë. Një Kuvend i konstituuar pas afatit kushtetues do të rezultonte gjithashtu edhe me pengesa në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Presidentes së Republikës siç është sqaruar në detaje përgjatë kësaj kërkesë.
71. Prandaj, me qëllim të parandalimit të dëmeve të pariparueshme për vendin, dhe si çështje me interes tejet të lartë publik, i kërkojmë me respekt Gjykatës Kushtetuese pezullimin e rrjedhjes së afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës deri në vendosjen, lidhur me meritat e këtij rasti.

V. PËRFUNDIM

72. Nga sa u tha më lartë, vërtetohet se mungesa e Kuvendit dhe fakti që kemi një Qeveri në detyrë me kompetenca të kufizuara dhe pa mbikëqyrje parlamentare, si dhe cenimi dhe konflikti i kompetencave në mes pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, përfshirë cenimin e ushtrimit të kompetencave kushtetuese të Presidentes, po rezultojnë gjithashtu me rrezikim të (a) ushtrimit të sovranitetit të Republikës së Kosovës përmes përfaqësuesve të zgjedhur (neni 2 i Kushtetutës), (b) formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushteteve (neni 4 i Kushtetutës), dhe c) vlerave të Republikës së Kosovës (neni 7 i Kushtetutës).
73. Andaj, në interes të mbrojtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të parimeve të ndarjes së pushteteve e vlerave demokratike në vend, si dhe në ushtrim të kompetencës së garantimit të funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve sipas neneve 4 dhe 84 të Kushtetutës, Presidentja kërkon me respekt nga Gjykata që:
- I. Ta shpallë kërkesën të pranueshme;
 - II. Ta miratojë kërkesën për masë të përkohshme;
 - III. Ta bëjë vlerësimin preventiv (*ex ante*) të konfliktit të kompetencave mes institucioneve kushtetuese në rast të konstituimit të Kuvendit pas afatit kushtetues;
 - IV. Ta zgjidhë konfliktin kushtetues të kompetencave, përfshirë lidhur me pasojat juridike të mungesës së konstituimit të Kuvendit brenda afatit të caktuar në nenin 66 (1) të Kushtetutës dhe Aktgjykimit KO 124/25;
 - V. Ta zgjidhë konfliktin kushtetues të kompetencave, përfshirë lidhur me pasojat juridike të konstituimit të Kuvendit pas afatit të caktuar në nenin 66 (1) të Kushtetutës dhe Aktgjykimit KO 124/25;
 - VI. Ta zgjidhë konfliktin e kompetencave, përfshirë lidhur me pasojat në ushtrimin e kompetencave të Presidentes së Republikës në raport me një Kuvend që mund të

konstituohet pas afatit të caktuar në nenin 66 (1) të Kushtetutës dhe Aktgjykimit KO 124/25;

VII. T'i sqarojë të gjitha efektet e tjera juridike lidhur me moskonstituimin e Kuvendit brenda afatit kushtetues.

Me respekt,

Vjosa Osmani – Sadriu

Presidente e Republikës së Kosovës